LIGJ
Nr. 164/2013

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE ARTIGIANCASSA S. P. A. PËR PROGRAMIN "FUQIZIMI I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT RURAL DHE TË AGRIKULTURËS PËR DISBURSIMIN E GRANTEVE NË AGRIKULTURË"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa S. p. A. për programin "Fuqizimi i Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe të Agrikulturës për disbursimin e granteve në agrikulturë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.10.2013

Shpallur me dekretin nr. 8385, datë 12.11.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

F.ROT. /NDIHMË 11/003/00

MARRËVESHJE FINANCIARE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE ARTIGIANCASSA S.P.A.
5.000.000,00 EURO

PROGRAM PËR FUQIZIMIN E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT RURAL DHE TË AGRIKULTURËS (AZHRA) PËR DISBURSIMIN E GRANTEVE NË AGRIKULTURË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu e më poshtë i quajtur "Huamarrësi"), nga njëra anë, dhe Artigiancassa S.p.A., anëtare e grupit bankar Banca Nazionale del Lavoro, e regjistruar në Regjistrin e Bankave, kapitali aksionar 6 300 000,00 euro me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, kodi

tatimor VAT nr. 10251421003 (më poshtë quhet "Artigiancassa"), si administratore, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë, e Fondit Qarkullues të Bashkëpunimit për Zhvillimin, të themeluar me nenin 26 të ligjit italian nr. 227, datë 24 maj 1977, dhe më tej të parashikuar në nenin 6 të ligjit italian nr. 49, datë 26 shkurt 1987, të përfaqësuar nga z. Stefano Gatti, shef i njësisë së menaxhimit të fondit qarkullues, nga ana tjetër, Artigiancassa dhe Huamarrësi së bashku (që këtu e më poshtë të quajtur "Palët"), kanë vendosur të lidhin këtë marrëveshje financiare.

Neni 1
Përkufizime

Në marrëveshjen financiare dhe në shtojcat e saj, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

- "Njohja e borxhit" është deklarata e parashikuar në nenin 12, nëpërmjet së cilës Huamarrësi merr përsipër, në favor të Artigiancassa-s, të rimbursojë shumën principale të kërkueshme në lidhje me huan e butë;
- "Marrëveshja" është kjo marrëveshje financiare, preambula dhe shtojcat e saj, që përbëjnë pjesë integrale të saj;
- "Shoqëri auditimi" është një shoqëri tepër e kualifikuar, e madhe ndërkombëtare auditimi. Shoqëria audituese do të zgjidhet dhe ngarkohet nga MAFCP-ja me detyrën e auditimit të dokumenteve dhe procedurave financiare dhe administrative në lidhje me shumën maksimale të huas së butë, sipas parashikimit në nenin 5;
- "Llogari e Banca Nazionale del Lavoro S.p.A." është llogaria (IBAN: IT29U0100503214000000250013–BIC BNLIITRR), e hapur te Banca Nazionale del Lavoro S.p.A., në emër të Artigiancassa/Gestione Fondo Rotativo L.49/87 - Ministero Economia e Finanze, në të cilën Huamarrësi do të shlyejë borxhin;
- "Raport financiar" është raporti financiar, i certifikuar nga shoqëria e auditimit, i lëshuar nga MAFCP-ja;
- "Periudha pa interesa" është periudha që zgjat 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj, që fillon në datën e disbursimit të parë;
- "Autoritetet kompetente italiane" është Ministria e Ekonomisë dhe Financës dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë dhe/ose çdo subjekt tjetër kompetent i qeverisë së Republikës së Italisë, të caktuar për qëllimin e kësaj marrëveshjeje;
- "MAE/DGCS" është Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë – Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin e Zhvillimit;
- "MEF" është Ministria e Ekonomisë dhe Financës së Republikës së Italisë;
- "MAFCP" është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MAFCP) së Republikës së Shqipërisë;
- "PA" është marrëveshja e programit e nënshkruar më 12 dhjetor 2012 në Tiranë ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga MAE/DGCS dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga MAFCP-ja e Republikës së Shqipërisë për realizimin e programit;
- "PMU" është njësia e menaxhimit të programit sipas MAFCP-së, që është subjekti përgjegjës për ekzekutimin dhe menaxhimin e programit;
- "Programi" është programi për fuqizimin e Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe të Agrikulturës (AZHRA) për disbursimin e granteve në agrikulturë, që duhet të financohen nëpërmjet huas së butë në përputhje me PA-në dhe këtë marrëveshje;
- "Hua e butë" është financimi që Artigiancassa, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, do të japë me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje;

- "Llogari e veçantë" është llogaria e veçantë e hapur nga Huamarrësi te Banka e Shqipërisë, në të cilën do të kreditohet shuma maksimale prej 551.400,00 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00) në tri këste dhe pastaj transferohet në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri;

- "Kontratë/a furnizimi" janë kontratat në lidhje me furnizimin me mallra dhe/ose shërbime ndërmjet furnitorit dhe MAFCP-së në lidhje me realizimin e programit.

Neni 2
Preambulë

2.1 Nëpërmjet PA-së të nënshkruar më 12 dhjetor 2012 në Tiranë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga MAFCP-ja dhe qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga MAE/DGCS-ja, kjo e fundit ka marrë përsipër të financojë programin nëpërmjet një huaje të butë deri në një shumë maksimale prej 5.000.000,00 eurosh (pesë milionë/00). Huaja e butë ndahet në dy komponentë: 1) deri në një shumë maksimale prej 551.400,00 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e një/00) eurosh të disbursuar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 7, që synon menaxhimin e fondeve drejtpërdrejt nga MAFCP-ja; 2) deri në një shumë maksimale prej 4.448.600,00 (katër milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind/00) të disbursuar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 10.

2.2 Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët synojnë: i) të zbatojnë dispozitat financiare në lidhje me huan e butë sipas parashikimit në nenin 8 të PA-së; dhe ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me PA-në.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe Financave e qeverisë së Republikës së Italisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr. 52817, datë 26 qershor 2012, ka autorizuar Artigiancassa-n t'i japë Huamarrësit një hua të butë me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje (këtu e më poshtë të quajtur "hua e butë") për qëllimin e financimit të programit.

Neni 3
Huaja e butë

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon huan e butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma: 5.000.000,00 euro (pesë milionë/00);
- Kohëzgjatja: 26 (njëzet e gjashtë) vjet;
- Periudha e faljes: 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj, që fillon në datën e disbursimit të parë;
- Shlyerja: 20 (njëzet) këste të njëpasnjëshme, të shpërndara në mënyrë të barabartë, gjysmëvjeçare të principalit, i pari prej të cilëve është 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj pas disbursimit të parë;
- Norma e interesit: 0.00% p.a. (zero pikë zero p.a.);
- Qëllimi i kredisë: "Program për fuqizimin e Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe të Agrikulturës (AZHRA) për disbursimin e granteve në agrikulturë".

3.2 Huaja e butë do të përdoret për përftimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 35 % (tridhjetë e pesë) për qind e huas së butë mund të përdoret për të mbuluar koston lokale.

Kontratat e furnizimit përcaktohen në euro.

3.3 Huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- mallrat dhe shërbimet në lidhje me, drejtpërdrejt ose jo, aktivitetet ushtarake;
- artikujt e luksit;
- tatimet e jo të ardhurave/fitimit (duke përfshirë TVSH-në) dhe detyrimet e importit;
- taksat lokale;
- për borxhet e papaguara dhe humbjet në të ardhmen për përfituesin ose përdoruesit përfundimtarë;
- interesat në pronësi të përfituesit ose përdoruesit përfundimtar të një pale të tretë.

3.4 Huaja e butë do të jetë e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje.

3.5 Huaja e butë do të disbursohet: 1) deri në një shumë maksimale prej 551.400,00 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00), në tri këste, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 7; 2) deri në një shumë maksimale prej 4.448.600,00 (katërqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind/00) në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 10.

3.6 Interesat e mbledhura, nëse do të ketë, për paratë e mbajtura në llogarinë e bankës së nivelit të dytë në Shqipëri, përdoren për financimin e programit.

Neni 4

Hyrja në fuqi e marrëveshjes financiare

4.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi Artigiancassa të ketë marrë dokumentet e mëposhtme nga Huamarrësi:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i qeverisë së Shqipërisë, që tregon zotësinë e Huamarrësit të nënshkruajë, në emër dhe për llogari të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, këtë marrëveshje nga një person i autorizuar rregullisht në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të plotë në Republikën e Shqipërisë për të ndërmarrë detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje;

ii) Emërimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Huamarrësit (nëpërmjet Ambasadës Italiane në Republikën e Shqipërisë) të personit ose personave të autorizuar rregullisht për të nënshkruar këtë marrëveshje, kërkesën e disbursimit në formën e shtojcës A, kërkesën për financimin e kontratës së furnizimit në formën e shtojcës B dhe njohjen e borxhit në formën e shtojcës E, të përmendur në nenin 12 më poshtë. Ky emërim do të specifikojë emrin dhe postin e këtij personi/ave dhe përmban "ekzemplarin" e përditësuar të nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim i saj (nëse do të ketë) do t'i transmetohet Artigiancassa-s në kohën e duhur nga Huamarrësi.

4.2 Artigiancassa, me marrjen plotësisht të pranueshme të dokumenteve të sipërpërmendura, do të njoftojë Huamarrësin dhe MAE/DGCS, me letër ose faks, që më pas duhet të konfirmohet me letër, datën në të cilën hyn në fuqi kjo marrëveshje.

Neni 5

Shoqëria audituese

5.1 MAFCP-ja do të ngarkojë një shoqëri auditimi, sipas nenit 5.2 të mëposhtëm, me detyrën e kryerjes së auditimit të operacioneve në lidhje me shumën maksimale të huas së butë të disbursuar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 7.

5.2 Kontrata ndërmjet MAFCP-së dhe shoqërisë së auditimit do t'i paraqitet për aprovim MAE/DGCS para nënshkrimit.

5.3 Shoqëria e auditimit përcakton një format standard të Raportit Financiar të Audituar. Ky

format duhet të aprovohet nga MAFCP-ja dhe Artigiancassa mbi bazën e aktiviteteve të rregulluara në PA dhe në këtë marrëveshje, dhe do t'i dërgohet nga MAFCP-ja, MAE/DGCS-së dhe për dijeni Artigiancassa-s.

5.4 Raporti Financiar i Audituar: i) do të ketë të bëjë me raportet financiare dhe teknike të dërguara nga MAFCP-ja Artigiancassa-s dhe MAE/DGCS-së; dhe ii) do të marrë parasysh rregullshmërinë dhe përmbushjen e kushteve të vendosura në këtë marrëveshje të çdo veprimi financiar në lidhje me huan e butë.

5.5 Shoqëria e auditimit do të certifikojë raporte financiare të audituara, në përputhje me nenin 7, që duhet të aprovohen nga MAE/DGCS dhe Artigiancassa.

Neni 6

Termat e disbursimit të huas së butë

6.1 Periudha e disbursimit të huas së butë do të përfundojë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Kjo periudhë mund të shtyhet nga Artigiancassa vetëm pas kërkesës paraprake të Huamarrësit. Artigiancassa nuk mund të shtyjë periudhën e disbursimit në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk bien dakord me një shtyrje të tillë dhe për këtë e kanë njoftuar me shkrim Artigiancassa-n të paktën 30 (tridhjetë) ditë para datës së përfundimit të periudhës së disbursimit.

6.2 Në rast se periudha e disbursimit ka përfunduar dhe nuk mund të shtyhet, Artigiancassa, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 7

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huas së butë deri në shumën maksimale prej 551.400,00 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00) euro

7.1 Artigiancassa do të ekzekutojë kërkesat për disbursim, në përputhje me dispozitat e specifikuara këtu, pasi:

i) kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi;

ii) konfirmimit nga Huamarrësi, nëpërmjet MAFCP-së, drejtuar Artigiancassa-s dhe MAE/DGCS-së, në lidhje me funksionalitetin e organeve për zbatimin e programit, të përmendura në PA;

iii) marrjes së komunikimit nga MAFCP-ja, nëpërmjet MAE/DGCS-së, në lidhje me përzgjedhjen e shoqërisë së auditimit;

iv) një deklarimi që certifikon hapjen e llogarisë së veçantë sipas specifikimit në përkufizime;

v) "moskundërshtimit" përkatës të MAE/DGCS-së mbi emërimin e shoqërisë së auditimit të përzgjedhur në përputhje me dispozitat e nenit 5.

7.2 Secila kërkesë për disbursim do të ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh, duke filluar nga data e marrjes së kërkesës nga Artigiancassa. Shuma prej 551.400,00 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00) do të alokohet në tri këste dhe interesi i përfituar, nëse do të ketë, nga llogaria në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri do të grumbullohet dhe përdoret për financimin e programit.

7.3 Kërkesa e parë për disbursim e transmetuar nga MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me shtojcën A për një shumë të barabartë me 50% (pesëdhjetë për qind) të shumës prej 551.400,00 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00), që kreditohet pas përmbushjes së kushteve të përmendura në nenin 7.1.

7.4 Kërkesa e dytë për disbursim, e transmetuar nga MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të

Huamarrësit, me mbështetjen e PMU-së, në përputhje me shtojcën A për shumën e barabartë me 30% (tridhjetë) të shumës prej 551.400,00 eurosh (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00), do të kreditohet pas angazhimit të të paktën 80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së këstit të parë, dhe përdorimit të të paktën 40% (dyzet për qind), dhe pas verifikimit dhe aprovimit të MAE/DGCS-së dhe Artigiancassa-s të Raportit Financiar të përgatitur nga MAFCP-ja dhe të certifikuar nga shoqëria e auditimit. Raporti Financiar i Audituar do t'i bashkëngjitet shtojcës A dhe do të përmbajë hollësi duke treguar vlefshmërinë e çdo kontrate. MAE/DGCS-ja dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe MAFCP-në në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes të Raportit Financiar të Audituar. Në rast se shoqëria e auditimit vë në dukje ndonjë parregullsi, Artigiancassa, në bashkëpunim me MAE/DGCS-në, do të ngurtësojë disbursimin e këstit të dytë. Vetëm pas shpjegimit të këtyre parregullsive nga shoqëria e auditimit dhe MAFCP-ja, do të lejohet disbursimi i këstit të dytë.

7.5 Nëse disa prej operacioneve të përfshira në Raportin Financiar të Audituar nuk do të aprovohen nga shoqëria e auditimit, dhe/ose nga MAE/DGCS-ja dhe Artigiancassa, kësti i dytë do të çlirohet vetëm pasi llogaria e veçantë të jetë rimbushur nga MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, me një shumë të barabartë me operacionet që nuk janë aprovuar.

7.6 Kërkesa e tretë për disbursim, e transmetuar nga MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, me mbështetjen e PMU-së, në përputhje me shtojcën A për shumën e barabartë me 20% (njëzet) të shumës prej 551.400,00 eurosh (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind/00), do të kreditohet pasi MAFCP-ja të ketë angazhuar një shumë më të lartë se 80% (tetëdhjetë për qind) të shumës pas këstit të parë dhe të dytë, dhe të ketë përdorur të paktën 40% (dyzet për qind) të kësteve të disbursuara. MAFCP-ja do t'i dërgojë MAE/DGCS-së dhe Artigiancassa-s një raport financiar të audituar të certifikuar nga shoqëria audituese. MAE/DGCS-ja dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe MAFCP-në në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes të Raportit Financiar të Audituar. Në rast se shoqëria e auditimit vë në dukje disa parregullsi, Artigiancassa, në bashkëpunim me MAE/DGCS-në, do të ngurtësojë disbursimin e këstit të dytë. Vetëm pas shpjegimit të këtyre parregullsive nga shoqëria e auditimit dhe MAFCP-ja, do të lejohet disbursimi i këstit të tretë. Nëse është e nevojshme, do të zbatohen dispozitat e nenit 7.5.

7.7 Menjëherë sapo fondet e disbursuara të jenë angazhuar dhe disbursuar, MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do t'i dërgojë MAE/DGCS-së dhe Artigiancassa-s një Raport Financiar Final të Audituar të certifikuar nga shoqëria e auditimit. MAE/DGCS-ja dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe MAFCP-në në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes të Raportit Financiar Përfundimtar të Audituar.

7.8 Huamarrësi, nëpërmjet MAFCP-së, merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme t'i rikthejë Artigiancassa-s shumat e barabarta me shpenzimet që nuk janë certifikuar nga shoqëria e auditimit dhe/ose që nuk janë aprovuar nga MAE/DGCS-ja dhe Artigiancassa.

7.9 Nëse ndonjë shumë e kredituar Huamarësit nga Artigiancassa nuk do të përdoret brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e disbursimit të fundit, kjo shumë do t'i kthehet menjëherë Artigiancassa-s nga MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit. Kjo transfertë do të bëhet pa vonesë pas komunikimit, të rënë dakord me MAE/DGCS-në, nga Artigiancassa drejtuar Huamarrësit dhe MAFCP-së, dhe patjetër brenda një muaji nga komunikimi i Artigiancassa-s.

7.10 Pas disbursimit të parë të fondeve në llogarinë e veçantë, Artigiancassa do t'i transmetojë Huamarrësit me letër, grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar, duke treguar datat e pagesave në lidhje me to. Pas çdo disbursimi të fondit, Artigiancassa do t'i transmetojë Huamarrësit grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar. Çdo grafik shlyerjeje, i plotësuar në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 11, do të pranohet nga Huamarrësi me shkrim.

Neni 8

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huas së butë deri në shumën maksimale prej 4.448.600,00 (katër milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind/00) euro

8.1 Huaja e butë deri në shumën maksimale prej 4.448.600,00 (katër milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind/00) eurosh mund të përdoret nga MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, me përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

i) kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi;

ii) leje e dhënë nga autoritetet kompetente italiane për alokimin e kontratave të furnizimit te huaja e butë;

iii) rezultat pozitiv i hetimit të kryer nga Artigiancassa sipas nenit 8.2/i më poshtë;

iv) marrjes nga Artigiancasa të kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit të parashikuar nga neni 9.1 më poshtë.

8.2 Me marrjen e autorizimit të përmendur në nenin 8.1/i më sipër, Artigiancassa do të procedojë menjëherë si më poshtë;

i) bën kontrollin mbi bazën e kërkesave të parashikuara nga autoritetet kompetente italiane, për furnitorin dhe individët/shoqëritë italiane (nëse ka) të përfshira me organizatën lokale dhe të kontratës/ave të furnizimit. Në lidhje me kontratën/at e furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato të jenë në përputhje me termat dhe kushtet e huas së butë dhe që ato të jenë të hollësishme në masën e mjaftueshme në lidhje me detajimin e kostove/çmimeve;

ii) njofton MAFCP-në, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, PMU-në dhe furnitorin për marrjen e autorizimit sipas nenit 8.1/i më sipër dhe i kërkon MAFCP-së të paraqesë kërkesën e parashikuar në nenin 9.1.

8.3 Rezultati pozitiv i hetimit të bërë nga Artigiancassa sipas nenit 8.2/i më sipër do të shkaktojë alokimin e kontratave të furnizimit te huaja e butë. Financimi i kontratës/ave të furnizimit do të kryhet vetëm pas përmbushjes së kushtit të parashikuar sipas nenit 8.1/iii.

8.4 Artigiancassa do të njoftojë me letër ose faks MAFCP-në, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, MAE/DGCS-në, PCU-në dhe furnitorin për alokimin dhe financimin e kontratës/ave të furnizimit.

Neni 9

Kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit

9.1 Pas njoftimit të rezultatit pozitiv të hetimit sipas nenit 8.2/i, MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do t'i transmetojë Artigiancassa-s një letërkërkesë për financimin e kontratës së furnizimit, të nevojshme për pagesat e parashikuara në secilën kontratë furnizimi. Nëpërmjet një kërkese të tillë, e cila do të ketë formën e shtojcës B, MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do të njohë që kontrata e furnizimit është e përshtatshme për t'u financuar dhe do të ndërmarrë t'i rimbursojë Artigiancassa-s shumën e disbursuar.

9.2 Letërkërkesa për financimin e kontratës së furnizimit, e parashikuar sipas nenit 9.1 do të merret në kohën e duhur dhe asnjëherë më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga Artigiancassa të parashikuar në nenin 8.3 më sipër ose në afatin (nëse ka) të parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas përfundimit të periudhës së përmendur më sipër, Artigiancassa, pas konsultimeve me autoritetet kompetente italiane, do të marrë në konsideratë anulimin e mundshëm të kontratave të furnizimit të alokuara, huan e butë.

Neni 10

Procedura e disbursimit deri në shumën maksimale prej 4.448.600,00 (katër milionë e

katërqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind/00) eurosh

10.1 Furnitori do t'i paraqesë Artigiancassa-s dokumentacionin kontraktual dhe do t'i kërkojë disbursimin, në përputhje me kontratën e furnizimit, të shumës përkatëse në formën e shtojcës C. Artigiancassa do të kontrollojë dokumentacionin kontraktual. Ky kontroll do të përfshijë përputhjen e dokumentacionit kontraktual me kontratën e furnizimit.

10.2 Në rast se Artigiancassa vëren mospërputhje në dokumentacionin kontraktual, ajo do të informojë me faks furnitorin që do t'i dërgojë dokumentet e korrigjuara Artigiancassa-s. Pas rishikimit pozitiv të dokumentacionit kontraktual, Artigiancassa do t'i dërgojë me korrier kopjen origjinale të dokumentacionit kontraktual MAFCP-së, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, dhe një kopje PMU-së.

10.3 Artigiancassa do të disbursojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për disbursim për parapagesat e parashikuara në kontratat e furnizimit. Për sa u përket pagesave të tjera, PMU-ja, nëpërmjet MAFCP-së, duhet t'i dërgojë Artigiancassa-s autorizimin e disbursimit, me qëllim që të kryejë pagesat në favor të furnitorit.

10.4 Pas hetimit të suksesshëm të parashikuar në nenin 10.3 më sipër, Artigiancassa do t'i konfirmojë me letër ose faks drejtuar MAFCP-së dhe Huamarrësit shumën e përgjithshme të disbursimit dhe datën në të cilën janë kredituar fondet. Ky komunikim do t'i dërgohet MAFCP-së dhe Huamarrësit me grafikun e shlyerjes, siç përmendet në nenin 10.6.

10.5 Artigiancassa do të bëjë pagesat në favor të furnitorit/ëve dhe do të marrë nga këta furnitorë dëftesën e shkarkimit të parashikuar në shtojcën D në dy kopje origjinale, një prej të cilave do t'i dërgohet MAFCP-së dhe një kopje Huamarrësit.

10.6 Pas çdo pagese në favor të furnitorit/ëve, Artigiancassa do t'i dërgojë me shkrim MAFCP-së dhe Huamarrësit një grafik shlyerjeje të shumës së disbursuar, duke treguar datat e kërkuara të pagesës në lidhje me to në përputhje me nenin 11 më poshtë. MAFCP-ja, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do të konfirmojë me shkrim pranimin e sipërpërmendur të grafikut të shlyerjes.

Neni 11
Shlyerja e huas së butë

11.1 Çdo shumë e disbursuar nga Artigiancassa do të shlyhet në përputhje me grafikun e shlyerjes në 20 (njëzet) këste të njëpasnjëshme, të shpërndara në mënyrë të barabartë, gjysmëvjeçare (prej këtu e më poshtë të quajtura "Këste të principalit"), i pari prej të cilëve është i kërkueshëm 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj nga data e kreditimit të disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit grafikun e parashikuar të shlyerjes në përputhje me nenet 7.10 dhe 10.6.

11.2 Për kështet e principalit të kredituara efektivisht dhe të papaguara, interesi i vonuar do të llogaritet me një normë vjetore nominale prej 0,00% (zero pikë zero për qind).

11.3 Huamarrësi merr përsipër të bëjë të gjitha shlyerjet e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje, si dhe sipas njohjes së borxhit pa vonesë në datën përkatëse të kërkueshme për shumën përkatëse në euro, në favor të Artigiancassa-s. Këto shuma do të kreditohen pa zbritje të asnjë tarife bankare apo këmbimi dhe/ose tatimi dhe pa njoftuar për këtë Artigiancassa-n ose personat me këtë të drejtë. Huamarrësi do të marrë një njoftim para datës së pagesës së kërkueshme. Nëse Huamarrësi, për një arsye çfarëdo, nuk e merr njoftimin e sipërpërmendur, ai gjithsesi do të marrë përsipër të bëjë të gjitha shlyerjet në përputhje me grafikun e shlyerjes pa vonesë. Për çdo shlyerje, Huamarrësi do t'i bëjë të ditur Artigiancassa-s numrin e marrëveshjes financiare dhe shumën e përgjithshme të huas së butë, dhe do të detajojë për çdo datë të kërkueshme shumat e paguara.

Neni 12
Dhënia e njohjes së borxhit

12.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e skadimit të disbursimit të huas së butë, të parashikuar në nenin 6.1, Huamarrësi do t'i paraqesë Artigiancassa-s njohjen e borxhit nënshkruar rregullisht dhe të sigluar nga Huamarrësi në çdo faqe, në formatin e shtojcës E.

12.2 Grafiku i shlyerjes i parashikuar në njohjen e borxhit do të plotësohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit që nuk janë maturuar akoma, të parashikuara në grafikun përkatës të shlyerjes për çdo disbursim, në përputhje me dispozitat e neneve 7.10 dhe 10.6.

12.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrimin dhe administrimin e saj dhe herë pas here regjistron në njohjen e borxhit çdo pagesë të shumës së principalit dhe, sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit, ia kthen atë Huamarrësit të nënshkruar rregullisht për marrje.

Neni 13
Detyrimi i Huamarrësit

Detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumat e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje dhe njohjes së borxhit në lidhje me të është i pavarur, absolut, pa kushte dhe i pakthyeshëm.

Neni 14
Pengesat dhe forca madhore

Në rastin e pengesave për zbatimin e programit për shkak të forcave madhore (si: luftës, përmbytjes, tajfunit, zjarrit, tërmetit, konflikteve të punës dhe grevave, akti të çdo qeverie, vështirësi të papritura transporti dhe shkaqe të tjera) do të zbatohen dispozitat e specifikuara në nenin 13 të PA-së. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e autoriteteve kompetente italiane në lidhje me aktivitetet e programit.

Neni 15
Pezullimi i disbursimit

15.1 Gjatë periudhës së disbursimit të huas së butë, Artigiancassa rezervon të drejtën të pezullojë çdo kërkesë disbursimi sipas neneve 7 dhe 10 në rastin e ndonjë vonese kundrejt Artigiancassa-s, sipas kësaj marrëveshjeje apo në rast se ndodh një vonesë ndaj ndonjë huaje të butë tjetër të dhënë nga qeveria e Republikës së Italisë për qeverinë ose Bankën Qendrore ose për agjencitë shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 38 të datës 9 shkurt 1979, dhe nenit 6 të ligjit nr. 49 të datës 26 shkurt 1987 të Republikës së Italisë, të ndryshuar herë pas here. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin për këtë pezullim.

15.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë për disbursim të parashikuar në nenet 7 dhe 10, në rast se shumat përkatëse bëhen të disponueshme nga autoritetet kompetente italiane. Artigiancassa nuk do të konsiderohet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit, në rast se shumat që duhet të disbursohen sipas huas së butë, nuk ofrohen nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 16

Interesi i munguar

16.1 Nëse për një arsye çfarëdo, Artigiancassa nuk merr shumat e kërkueshme për principalin brenda datës së kërkueshme, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë, për shumat në fjalë, interesin e munguar nga data e kërkueshme deri në datën e kreditimit faktik në favor të Artigiancassa-s.

16.2 Ky interes i munguar do të llogaritet duke zbatuar formulën e thjeshtë të interesit. Interesi i munguar nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të kërkueshme dhe, pas kësaj, me normën 1,75% (një pikë shtatëdhjetë e pesë për qind) deri në datën e kreditimit faktik në favor të Artigiancassa-s. Ky interes i munguar do të llogaritet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 17
Tatimet

17.1 Çdo taksë e tanishme apo e ardhshme, që mund të jetë e kërkueshme në Republikën e Shqipërisë, për një arsye çfarëdo në lidhje me këtë marrëveshje dhe njohjen e borxhit, do të mbulohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

17.2 Çdo taksë e kërkueshme në Itali në lidhje me këtë marrëveshje, nuk do të mbulohet nga Huamarrësi.

17.3 Artigiancassa deklaron se do të përdorë statusin tatimor të parashikuar në nenin 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 601 të datës 29 shtator 1973, të ndryshuar herë pas here.

Neni 18
Ligji rregullues

Kjo marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 19
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

19.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga interpretimi dhe/ose ekzekutimi i kësaj marrëveshjeje.

19.2 Nëse këto përpjekje nuk do të çojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda një periudhe kohe të arsyeshme, mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

19.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë apo (nëse përpjekja bëhet), ajo do të ketë një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet nga ose në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi e përbërë nga tre arbitra:

- një i emëruar nga Huamarrësi;
- një i emëruar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë emërohet nga arbitrat e sipërpërmendur ose, në rast mosmarrëveshjeje mes tyre, nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

19.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk i emërojnë arbitrat e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, arbitri do të emërohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

19.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila vendos në përputhje me ligjin e Republikës së

Italisë, do të jetë përfundimtar dhe detyrues pa kushte për të dyja palët dhe pa asnjë mundësi ankimimi.

19.6 Asnjë mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë ndërmjet palëve, nuk do të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat e kërkueshme të rëna dakord, të gjitha shumat e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje dhe, veçanërisht të gjitha shumat që rrjedhin nga grafiku i shlyerjes, i parashikuar në nenet 7 dhe 10 dhe nga njohja e borxhit në lidhje me të.

Neni 20

Njoftimet

Njoftimet që bëhen në përputhje me këtë marrëveshje do të adresohen si më poshtë:

- Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1, Tirana, Albania

Tel.: +355 -4- 2228405 - Fax: +355 -4- 2228494

- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MAFCP) e Republikës së Shqipërisë, Njësia e Koordinimit të Programit, Sheshi Skënderbej

Tel: +355-4-2232796, Fax: +355-4-2227924

- Artigiancassa S.p.A., Njësia e Menaxhimit të Fondit Qarkullues, Via Crescenzo Del Monte 25, - 00153, Rome, Italy

Telefoni i zyrës: +39-06/5845374/414, Fax: +39-06/5845466

e-mail: fondorotativo@artigiancassa.it

Neni 21

Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje financiare duhet të bëhet me shkrim ndërmjet Artigiancassa-s dhe Huamarrësit. Ministri i Financave i Shqipërisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje financiare që prekin vetëm termat e disbursimit, nuk do të kërkojnë aprovimin paraprak të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë.

Neni 22

Tekstet origjinale të marrëveshjes financiare

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri kopje origjinale në gjuhën angleze. Artigiancassa mban dy kopje origjinale dhe Huamarrësi një kopje origjinale.

Artigiancassa S.p.A. Nënshkruar në ..... më	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave Nënshkruar në ..... më .....

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

SHTOJCA A

Nga: …. (MAFCP-ja në emër dhe për llogari të Huamarrësit)

Drejtuar: Artigiancassa

Marrëveshja financiare prej ..... euro e nënshkruar prej nesh në ..... më ..... dhe nga Artigiancassa në ..... më .....

Në pajtim me nenin 7 të marrëveshjes financiare të sipërpërmendur, ne kërkojmë që të kreditoni brenda 30 (tridhjetë) ditësh në llogarinë e veçantë (sipas përcaktimit të atjeshëm) nr. IBAN …… dhe të hapur te Banka …….., shumën prej EURO …….(…..), me kusht që fondet përkatëse të jenë bërë të disponueshme nga autoritetet kompetente italiane (sipas përcaktimit të atjeshëm).

Fondet e kredituara nga ju në llogarinë e veçantë do të përdoren për zbatimin e programit "…..".

Ne marrim përsipër pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme të shlyejmë shumën e sipërpërmendur prej ..... eurosh, të kredituar prej jush në llogarinë e veçantë, sipas termave dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen financiare të sipërpërmendur.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e përfundimit të disbursimit të huas së butë të parashikuar në nenin 6 të marrëveshjes financiare, ne marrim përsipër t'i paraqesim Artigiancassa S.p.A. një njohje të borxhit për të gjitha shumat e disbursuara sipas marrëveshjes financiare të sipërpërmendur.

Kjo njohje e borxhit do të jetë në formën e shtojcës E të marrëveshjes financiare të sipërpërmendur.

Sinqerisht juaji,

Datë ... (Nënshkrimi i MAFCP-së)

……

FORMULARI I KËRKESËS PËR FINANCIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT
SHTOJCA B

Nga: ..... (MAFCP në emër dhe për llogari të Huamarrësit)

Drejtuar: Artigiancassa-s

Marrëveshje financiare në EURO..... ..... (.....) nënshkruar nga …… në ..... më ..... dhe nga Artigiancassa në .... më .....

Në përputhje me nenin 9 të marrëveshjes financiare të sipërpërmendur, do të donim t'ju informonim se kontrata e furnizimit bashkëngjitur, nr. ..... datë ..... ndërmjet ..... dhe ..... në lidhje me ..... (programi), është e përshtatshme për t'u financuar.

Si rezultat, ju kërkojmë të financoni shumën përkatëse në EURO …… (……), e cila u korrespondon pagesave të detyrueshme nga ne për ..... (furnitorin), që ju do të bëni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Për këtë qëllim, ne pranojmë se pagesat që ju do të kryeni në favor të furnitorit të treguar nga ne do të pasojnë: i) dorëzimin nga ky furnitor të dokumentacionit kontraktual; ii) kontrollin e suksesshëm të dokumentacionit kontraktual sipas nenit 10.2 të marrëveshjes financiare; iii) miratimin e MAFCP-PCU, sipas nenit 10.3; dhe iv) dorëzimin e një dëftese shkarkimi në dy kopje origjinale.

Në këtë aspekt, ju do të na dërgoni origjinalin e dokumentacionit kontraktual, si dhe dy kopjet origjinale të kësaj dëftese shkarkimi.

Ne konfirmojmë që qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër pa kushte dhe në

mënyrë të pakthyeshme të shlyejë çdo shumë të kredituar prej jush në llogarinë e furnitorit sipas termave dhe kushteve të dhëna sipas marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e fundit e përfundimit të disbursimit për huan e butë e parashikuar në nenin 6 të marrëveshjes financiare, ne marrim përsipër të paraqesim një njohje borxhi për shumën principale që përputhet me shumën e përgjithshme të të gjitha disbursimeve të bëra sipas marrëveshjes financiare.

Kjo njohje e borxhit do të ketë formën e shtojcës E të marrëveshjes financiare.

Sinqerisht juaji,
Datë… .....
(Nënshkrimi i MAFCP-së)

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM
SHTOJCA C

Nga: .....(furnitori)
Drejtuar: Artigiancassa

Marrëveshje financiare në Euro..... ..... (.....) nënshkruar nga …… në ..... më ..... dhe nga Artigiancassa në .... më .....

Të dashur zotërinj,

Në lidhje me kontratën e furnizimit, nr. ....., datë ..... ndërmjet nesh dhe ..... (importues) për shumën e ..... euro (....), në lidhje me ..... (programi), ne ju dërgojmë dokumentacionin e mëposhtëm kontraktual për shumën prej ... (....) eurosh:

....
....
....

Ne ju kërkojmë që shuma e sipërpërmendur të disbursohet nga ju brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kësaj kërkese në llogarinë e mëposhtme bankare (banka e furnitorit):

IBAN: …….. Hapur në emër të:……. …. Banka: …… Nr. i telefonit të zyrës së degës:…… Nr. i faksit të zyrës së degës:……

Sinqerisht juaji,

Datë, ... Nënshkrimi
Konfirmojmë vërtetësinë e nënshkrimit
……..
(Banka e furnitorit)

FORMULARI I DËFTESËS SË SHKARKIMIT
SHTOJCA D

Nga: Furnitori
Drejtuar: ……. (MAFCP-së në emër dhe për llogari të Huamarrësit)
Drejtuar: Artigiancassa-s

DËFTESË SHKARKIMI

Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. ……, nënshkruar më ……..., ndërmjet shoqërisë sonë dhe ……. për furnizimin me …….., ne konfirmojmë që kemi marrë shumën prej …… (…….) eurosh si pagesë të pjesshme/të plotë për këtë kontratë furnizimi.

Kjo shumë ka të bëjë me huan e butë prej eurosh ……. (……..), të dhënë nga Artigiancassa qeverisë së ..., në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 49 të datës 26 shkurt 1987 që ndryshohet herë pas here, nëpërmjet marrëveshjes financiare, nënshkruar në ……., më ……. dhe në …, më …….

Kështu, ne konfirmojmë se na është paguar plotësisht shuma e pjesshme/e plotë e kërkueshme sipas huas së butë si pagesë të shumës në euro …….. (…….) dhe që Huamarrësi dhe Artigiancassa nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për ndonjë detyrim dhe përgjegjësi në lidhje me shumën e marrë.

Nënshkrimi
Konfirmojmë vërtetësinë e nënshkrimit
……..
(Banka e furnitorit)

FORMULARI I NJOHJES SË BORXHIT
SHTOJCA E

…….. (Huamarrësi)

N. .....
Vendi dhe data e lëshimit:

Në lidhje me marrëveshjen e programit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë të nënshkruar në ..., më ... dhe marrëveshjen financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (më poshtë "Huamarrësi") dhe Artigiancassa S.p.A. (më poshtë "Artigiancassa"), të nënshkruar në … më ....., dhe në ….. më ....., Huamarrësi njeh marrjen e shumave të mëposhtme nga Artigiancassa:

EURO ..... më .....
EURO ..... më .....

Kështu, Huamarrësi pa kushte dhe në mënyrë të parevokueshme deklaron që është debitor i Artigiancassa-s, si administrator, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë, të Fondit Qarkullues për Bashkëpunimin për Zhvillimin me seli të regjistruar në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte, 25, për shumën principale prej EURO ..... (.....) që ndërmerr të shlyejë në … (…) këste të barabarta (të njëpasnjëshme) gjysmëvjetore, i pari prej të cilëve bëhet i kërkueshëm më ..... dhe i fundit më ....., sipër grafikut të shlyerjes të parashikuar më poshtë.

Huamarrësi do të paguajë këstet e pricipalit (sipas përkufizimit në marrëveshjen financiare) të parashikuara në këtë njohje borxhi, duke kredituar shumat përkatëse në eurosh, në datat e rëna dakord, në favor të Artigiancassa-s, ose të personit/ave me këto të drejta, te llogaria te Banca Nazionale del Lavoro S.p.A., e lirë nga çdo tarifë bankare dhe/ose konvertimi.

Nëse Artigiancassa, për një arsye çfarëdo, duke përfshirë shkaqet përtej kontrollit të Huamarrësit, nuk merr shumat e kërkueshme për principalin të parashikuara sipas kësaj njohjeje borxhi brenda datës së kërkueshme, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë, për këto shuma, në llogarinë te Banca Nazionale del Lavoro S.p.A., interesin e munguar nga data e kërkueshme deri në datën faktike të kreditimit në favor të Artigiancassa-s ose të personit/ave me këto të drejta.

Ky interes i munguar do të llogaritet duke zbatuar formulën e thjeshtë të interesit. Interesi i munguar nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë ditësh) menjëherë pas datës fillestare të kërkueshme dhe, pas kësaj, do të llogaritet me normën 1,75% (një pikë shtatëdhjetë e pesë për qind) në vit deri në datën e kreditimit faktik në favor të Artigiancassa-s.

.....
(Inicialet e Huamarrësit)

të vazhdohet

SHTOJCA B ctd.

Artigiancassa do të shënojë herë pas here në këtë njohje borxhi çdo pagesë principali.

Menjëherë sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e renditura në grafikun e shlyerjes, të parashikuar më poshtë, kjo njohje borxhi do t'i kthehet Huamarrësit nëpërmjet Artigiancassa-s.

Kjo njohje borxhi lëshohet në lidhje me huan e butë prej 5,000,000.00 eurosh (pesë milionë/00) të dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 49 të datës 26 shkurt, 1987 të Republikës së Italisë.

GRAFIKU I SHLYERJES

Data e maturimit	**Këstet e principalit**	**Totali**
a)		.....
b)		.....
c)		.....
d)		.....
1)	.....	.....
2)	.....	.....
3)	.....	.....
4)	.....	.....
5)	.....	.....
6)	.....	.....
7)	.....	.....
8)	.....	.....
9)	.....	.....
10)	.....	.....

(.....)
(Nënshkrimi i Huamarrësit)